



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 1060 Prot
Nr. 1430 Dosje

Tiranë, më 13.08.2020

U R D H Ë R

PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT (QKB – TIRANË)

Unë Altin Vako, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 1939 Regj.Them, të lëshuar më datë 12.11.2019 prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 1430, Datë 21.07.2020 kërkesën e kreditorit Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (A.K.U), ndaj debitorit Shoqërisë "HODAJ" Sh.p.k., në lidhje me titullin ekzekutiv, Proces-Verbal i Inspektimit dhe Vendim Përfundimtar Nr. AKU-TR—2019-002917-5, datë 21.05.2019.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshem, duke i dërguar debitorit lajmërimin Nr. 982 Prot, Datë 23.07.2020 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhëri i ekzekutimit Nr. 1939 Regj.Them, Datë 12.11.2019, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOJ

Se debitori Shoqëria "HODAJ" Sh.p.k, ka marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit, dhe nuk i është pergjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër duke vënë sekuestër mbi aksionet e debitorit Shoqërisë "HODAJ" Sh.p.k dhe Z. Frenk Hodaj (në cilësinë e administratorit të Shoqërisë "HODAJ" Sh.p.k), në masen që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.



Për sa më sipër, në referim të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i I-re) të Ligjit Nr.10031, Datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, si dhe Nenit 39 të Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”

URDHËROJ

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga:
 - a) Shoqëria “HODAJ” Sh.p.k., me Nr. NIPT-i: K26925201M
Dhe
 - b) Z. Frenk Hodaj, (atësia: Ilir, datëlindja: 23.08.1995)
(në cilësinë e administratorit të Shoqërisë “HODAJ” Sh.p.k)
2. Pas vënies së masës së sekuestros, të informohemi në lidhje me:
 - a) adresën e ushtrimit të veprimtarisë private.
 - b) llojin e aktivitetit për të cilin është pajisur me licencë.
 - c) bllokimin e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimit të aktivitetit.
3. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
4. Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.
5. Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përmbarimor i referuar në K.Pr.Civile, pala debitore mundet të paraqesë ankim para Gjykatës Së Rrethit Gjyqësor, 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes njoftim të këtij urdhëri.
6. Ky urdhër përpilohet dhe mbahet në disa kopje.

PËRMBARUES GJYQËSOR

ALTIN VAKO



The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E SHQIPËRISË", "ALTIN V. VAKO", and "PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT".

